



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 21 korrik 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Đezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha dhe Vladimir Todoroviq.

Munguan: Suzana Novoberdaliu, Kolë Berisha, Ahmet Isufi dhe Besa Gaxheri.

Pjesëmarrës të tjerë: Liridon Selmani – KDI, Shefki Kastrati - NDI dhe Lumnije Tafili – Kabineti i Presidentit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri dhe Advije Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni – Kaloshi, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16. 07. 2010,
3. Interpretimi dhe zbatimi i Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i kërkesës për heqjen e statusit të deputetit Dragan Dimiq
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16. 07. 2010

Procesverbali u miratua me vërejtjen e kryetarit për ndarjen e punës së hartimit të rekomandimeve me anëtarin Suzana Novoberdaliu.

3. Interpretimi dhe zbatimi i Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari – Hyseni, tha se me gjithë faktin se kemi shumë dispozita dhe institucione, në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me të cilën do të duhej të merreshim, siç jemi pajtuar në mbledhjen e kaluar, sot do ta trajtojmë institucionin e votimit për rastet kur paraqiten dy ose më tepër amendamente alternative, që përjashtojnë njeri-tjetrin (neni 58.4 dhe neni 51.3 i Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës).

Në debat morën pjesë të gjithë anëtarët e pranishëm. Erdhën në përfundim se në seancat e Kuvendit shpesh herë ndodh që me rastin e votimit të amendamenteve alternative procedohen me votim dy amendamente për një nen të projektligjit. Edhe pse votimi i amendamentit të parë e merr shumicën e votave, shpesh krijohet situatë e paqartë se cili amendament ka më shumë vota.

Në bazë të këtij vlerësimi Komisioni e votoi njëzëri rekomandimin për Kryesinë e Kuvendit, si vijon:

1. Në pajtim me nenet 51.3 dhe 58.4 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe sipas praktikave të përparuara parlamentare, të rishikohet dhe të përmirësohet praktika e votimit të amendamenteve alternative, në mënyrë që të evitohen ndërlikimet dhe konfuzioni i shfaqur në mbledhjet e fundit. Komisioni sugjeron që, duke e ndjekur rendin e përcaktuar me Rregullore, të vihet në votim së pari amendamenti i Komisionit Funkcional ose ai i mbështetur nga Komisioni. Në rast se ai merr shumicën e votave të deputetëve në sallë, që votojnë, votimi të konsiderohet i kryer dhe të mos votohen amendamentet e tjera alternative. Kështu nënkuptohet se ato nuk kanë pasur mbështetjen e nevojshme. Nëse amendamenti i Komisionit ose ai i mbështetur nga Komisioni, nuk e merr shumicën e votave, atëherë votohet amendamenti vijues dhe kështu me radhë. Nëse asnjëri nga amendamentet nuk e merr shumicën e votave, konsiderohet i votuar varianti fillestar i propozimligjit.

Kryetari – Hyseni - Vlerësoi se do ishte i mirëseardhur dhe me shumë interes organizimi i një konference – punëtorie, të cilën edhe IND-ja ka shprehur vullnet ta mbështesë që të përvetësohen praktikat e mira parlamentare paralel me zbatimin e rregullave të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nëse do ta mbështetë edhe Kryesia e Kuvendit këtë organizim, besojmë se do jetë frytdhënëse për punën tonë të përbashkët në seancat dhe në mbledhjet e organeve të Kuvendit.

Për rëndësinë e organizimit të kësaj konference diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit dhe u pajtuan t'i rekomandohet Kryesisë, si vijon:

2. Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta shqyrtojë mundësinë që me mbështetjen e nevojshme të sajë dhe nën përkujdesjen e Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, të organizohet një konferencë ose një punëtori, lidhur me praktikën parlamentare për deklaratat dhe për pyetje parlamentare. Konferenca do të organizohet në fillim të sesionit vjetor parlamentar të këtij viti, në bashkëpunim edhe me Institutin Nacional Demokratik. Realizimi i një konference (workshop) të tillë, do të ishte në funksion të përvetësimit të standardeve demokratike, të pasurimit me praktikën e mira parlamentare, që do reflektohej nëpërmjet përvetësimit, respektimit dhe të zbatimit të tyre në përputhje me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, në punën e seancave të Kuvendit dhe të trupave të tij.

3. Shqyrtimi i kërkesës për heqjen e statusit të deputetit Dragan Dimiq

Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 korrik 2010, duke vepruar në pajtim me fushëveprimin e tij të paraparë në Rregulloren e Kuvendit, e shqyrtoi kërkesën e datës 19. 07. 2010 të Lidhjes Social-Demokratëve të Pavarur, për heqjen e mandatit të deputetit Dragan Dimiq dhe vendosi që Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ia paraqesë këtë;

Informatë si vijon:

Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, më 21. 07. 2010, e shqyrtoi kërkesën e përfaqësuesit të LSDP-së, Zhiviq Ljubisha - kryetar, me të cilën kërkohet heqja e mandatit të deputetit Dragan Dimiq, sepse është dënuar me një vit burg.

Provë: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.

Komisioni vlerësoi se kërkesa e përfaqësuesit të LSDP-së dhe aktgjykimi, nuk mund të trajtohen për prova zyrtare dhe të plotfuqishme, por vetëm si njoftim. Komisioni vlerësoi se për zhvillimin dhe për përfundimin e procedurës në pajtim me nenin 25, përkatësisht me paragrafët 1.e dhe 1.f) të Rregullores është e domosdoshme që kërkesa të jetë nga autoriteti kompetent dhe të ofrohen prova të pakontestueshme.

Aktgjykimi i bashkangjitur është i shkallës së parë, kurse neni 70. 3.6 i Kushtetutës thekson shprehimisht: “mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse... “d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale për një ose më shumë vjet burgim”.

Komisioni pret hapa eventuale të palëve kompetente ose sugjerimet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo informatë i dërgohet edhe deputetit, zotit Dragan Dimiq.

Pas këtyre vlerësimeve Komisioni konstatoi se Kryesia e Kuvendit duhet të njoftohet për këtë kërkesë, për gjendjen faktike, për kushtet, sipas të cilave mund të zhvillohet procedura dhe heqja e mandatit dhe të kërkojë këshilla si të veprohet.

5. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit për përparësitë e detyrave dhe për mënyrën e organizimit të punëve në Komision, që do të ndërmerren pas pushimit veror, që nga shtatori e tutje.

I falënderoi anëtarët e Komisionit për shkallën e bashkëpunimit dhe për punën e përbashkët për periudhën e sesionit pranveror. I njoftoi se mbledhja e parë e Komisionit pas pushimit veror do jetë në javën e dytë të shtatorit.

Njësia mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Hydajet HYSENI- KALOSHI